FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 82

Tiranë – E enjte, 6 qershor 2019

PËRMBAJTJA

		Faqe
Urdhër i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 283, datë 23.5.2019	Për hapjen e institucionit arsimor parauniversitar publik, të arsimit parashkollor "Kopshti" në fshatin Bularat, Njësia Administrative Dropull i Sipërm, bashkia Dropull	6131
Urdhër i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 305, datë 30.5.2019	Për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, gjimnazi "Univers Network", Tiranë	6131
Urdhër i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 307, datë 30.5.2019	Për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, shkolla 9-vjeçare "Visare", Kavajë	6132
Urdhër i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 309, datë 30.5.2019	Për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, gjimnazi "Eurolingua", Tiranë	6133
Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 429, datë 3.6.2019	Për delegimin e kompetencave	6134

URDHËR
Nr. 283, datë 23.5.2019

PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR PUBLIK, TË ARSIMIT PARASHKOLLOR "KOPSHTI" NË FSHATIN BULARAT, NJËSIA ADMINISTRATIVE DROPULL I SIPËRM, BASHKIA DROPULL

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 1, të nenit 41, të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të vendimit nr. 662, datë 8.10.2014, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për hapjen dhe për mbylljen e institucioneve arsimore parauniversitare publike" dhe udhëzimit nr. 30, datë 12.9.2018, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar", me propozim të Bashkisë Dropull

URDHËROJ:

1. Hapjen e institucionit arsimor parauniversitar publik, të arsimit parashkollor, "Kopshti" pranë fshatit Bularat, njësia administrative Dropull i Sipërm, Bashkia Dropull, propozuar me vendim nr. 13, datë 20.2.2019 të Këshillit Bashkiak Dropull.

2. Bashkia Dropull të realizojë procedurat për emërimin e stafit drejtues dhe mësimdhënies të kopshtit, bazuar në normat e punës mësimore-edukative dhe propozimin e saj.

3. Kopshti të fillojë veprimtarinë e tij në vitin mësimor 2019–2020.

4. Bashkia Dropull të sigurojë ambientet dhe infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin normal të veprimtarisë së kopshtit, sipas propozimit të saj.

5. Kopshti duhet të ketë në ruajtje dokumentacionin e mëposhtëm:

a) dokumentacionin themeltar në ruajtje të përhershme, si: regjistër amze, indeks alfabetik, regjistër të veçantë, statistika vjetore të numrit të fëmijëve dhe të mësuesve;

b) regjistra të përkohshëm, si: regjistra klase;

c) rregulloren e brendshme për funksionimin e institucionit.

6. Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, nën juridiksionin e të cilit do të hapet kopshti, të monitorojë veprimtarinë mësimdhënëse të këtij institucioni arsimor parauniversitar publik, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi.

7. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit në MASR, institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar dhe Bashkia Dropull.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

URDHËR
Nr. 305, datë 30.5.2019

PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR PRIVAT, GJIMNAZI "UNIVERS NETWORK", TIRANË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikave 3 dhe 7, të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të udhëzimit nr. 15, datë 12.7.2013 "Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, Gjimnazi "Univers Network", Tiranë, në përfundim të vitit shkollor 2018–2019.

2. Institucioni arsimor parauniversitar privat, Gjimnazi "Univers Network" ka këto detyrime:

a) të pajisë çdo nxënës me dokumentacionin e nevojshëm shkollor, që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit parauniversitar;

b) të vërë në dispozicion të institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë urdhër;

c) të kthejë pagesat e kryera nga nxënësit për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbushur që mund të ketë ndaj nxënësit;

d) të dorëzojë në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer;

e) të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për transferimin e nxënësve, në zbatim të këtij urdhri, të mbulohen nga institucioni përkatës i arsimit parauniversitar privat.

3. Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, nën juridiksionin e të cilit ndodhet shkolla, ka për detyrë:

a) të ngrejë grup pune dhe, brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, Gjimnazi "Univers Network";

b) të marrë masat për transferimin e nxënësve në institucione të tjera të arsimit parauniversitar për të gjithë nxënësit e regjistruar në këtë institucion arsimor;

c) të administrojë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga institucioni arsimor parauniversitar privat;

d) të ruajë në arkivin e institucionit dhe më tej të arkivojë sipas ligjit për arkivat, dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni arsimor parauniversitar privat, Gjimnazi "Univers Network".

4. Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të marrë të gjitha masat sipas parashikimeve të Kodit Civil, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, si dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi për personin juridik që përfaqëson institucionin e përcaktuar në pikën 1, i cili nuk zbaton këtë urdhër.

5. Urdhri nr. 26, datë 25.1.2016 i ministrit të Arsimit dhe Shkencës, "Për funksionimin e institucionit arsimor privat parauniversitar, shkollë e mesme e përgjithshme e profilizuar 'Univers Network'", shfuqizohet.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit në MASR, Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar dhe institucioni arsimor parauniversitar privat, Gjimnazi "Univers Network".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

URDHËR
Nr. 307, datë 30.5.2019

PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR PRIVAT, SHKOLLA 9-VJEÇARE "VISARE", KAVAJË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikave 3 dhe 7, të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të udhëzimit nr. 15, datë 12.7.2013 "Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, shkolla 9-vjeçare "Visare", e subjektit Shoqata "Visare" Kavajë, licencuar me licencë të QKL-së nr. LN-6409-04-2013, në përfundim të vitit shkollor 2018–2019.

2. Institucioni arsimor parauniversitar privat, shkolla 9-vjeçare "Visare" ka këto detyrime:

a) të pajisë çdo nxënës me dokumentacionin e nevojshëm shkollor, që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit parauniversitar;

b) të vërë në dispozicion të institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin dhe

mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë urdhër;

c) të kthejë pagesat e kryera nga nxënësit për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbushur që mund të ketë ndaj nxënësit;

d) të dorëzojë në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer;

e) të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për transferimin e nxënësve, në zbatim të këtij urdhri, të mbulohen nga institucioni përkatës i arsimit parauniversitar privat.

3. Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, nën juridiksionin e të cilit ndodhet shkolla, ka për detyrë:

a) të ngrejë grup pune, brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, dhe të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, shkolla 9-vjeçare "Visare";

b) të marrë masat për transferimin e nxënësve në institucione të tjera të arsimit parauniversitar publik ose privat, si dhe për garantimin e ndjekjes së shkollës për të gjithë nxënësit e regjistruar në këtë institucion arsimor;

c) të administrojë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga institucioni arsimor parauniversitar privat;

d) të ruajë në arkivin e institucionit dhe më tej të arkivojë sipas ligjit për arkivat, dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni arsimor parauniversitar privat, shkolla 9-vjeçare "Visare".

4. Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të marrë të gjitha masat sipas parashikimeve të Kodit Civil, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, si dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi për personin juridik që përfaqëson institucionin e përcaktuar në pikën 1, i cili nuk zbaton këtë urdhër.

5. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit në MASR, institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar dhe institucioni arsimor parauniversitar privat, shkolla 9-vjeçare "Visare".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

URDHËR
Nr. 309, datë 30.5.2019

PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR PRIVAT, GJIMNAZI "EUROLINGUA", TIRANË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 3 dhe 7 të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të udhëzimit nr. 15, datë 12.7.2013 "Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, Gjimnazi "Eurolingua", Tiranë, në përfundim të vitit shkollor 2018-2019.

2. Institucioni arsimor parauniversitar privat, Gjimnazi "Eurolingua" ka këto detyrime:

a) Të pajisë çdo nxënës me dokumentacionin e nevojshëm shkollor, që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit parauniversitar.

b) Të vërë në dispozicion të institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë urdhër.

c) Të kthejë pagesat e kryera nga nxënësit për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbushur që mund të ketë ndaj nxënësit.

d) Të dorëzojë në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer.

e) Të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për transferimin e nxënësve, në zbatim të këtij urdhri, të mbulohen nga institucioni përkatës i arsimit parauniversitar privat.

3. Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, nën juridiksionin e të cilit ndodhet shkolla, ka për detyrë:

a) Të ngrejë grup pune brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri dhe të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, Gjimnazi "Eurolingua".

b) Të marrë masat për transferimin e nxënësve në institucione të tjera të arsimit parauniversitar për të gjithë nxënësit e regjistruar në këtë institucion arsimor.

c) Të administrojë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga institucioni arsimor parauniversitar privat.

d) Të ruajë në arkivën e institucionit dhe më tej të arkivojë sipas ligjit për arkivat, dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni arsimor parauniversitar privat, Gjimnazi "Eurolingua".

4. Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar të marrë të gjitha masat sipas parashikimeve të Kodit Civil, ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, si dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi për personin juridik që përfaqëson institucionin e përcaktuar në pikën 1, i cili nuk zbaton këtë urdhër.

5. Urdhri nr. 32, datë 5.2.2007 i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, "Për funksionimin e institucionit arsimor privat parauniversitar, shkollë e mesme e përgjithshme e profilizuar "Eurolingua", shfuqizohet.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit në MASR, Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar dhe institucioni arsimor parauniversitar privat, Gjimnazi "Eurolingua".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

URDHËR
Nr. 429, datë 3.6.2019

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Ministrave" dhe të nenit 29, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Delegimin e plotë të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Brendshme, zëvendësministrit të Ministrisë së Brendshme, z. Julian Hodaj, nga data 4.6.2019 deri më datën 6.6.2019.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Brendshme, z. Julian Hodaj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Sandër Lleshaj

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 56 lekë